



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.794/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit E.H. Kafe Internacional, me seli në Podujevë, rr. “Llapi”, sipas dokumentit të besueshëm – Ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, PPP.nr.68/22 të datës 20.12.2022, me datën 28.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, PPP.nr.68/22 i datës 20.12.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore e Prishtinës- Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.68/22, të datës 20.12.2022, në pikën I të dispozitivit e ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit E.H. Kafe Internacional, dhe e ka shfuqizuar Urdhrin e Përmbareut Privat P.nr.97/2021 të datës 02.03.2021 të përmbareut private Emine Sherifi Lubeniqi, nga shuma 685.31 euro. Për periudhën para datës 31.12.2013 deri me 31/12/2017 kishte arritur shuma prej 393.12euro. Prandaj shuma e parashkruar për këtë periudhë deri me 31.12.2017 prej 393.14 euro e kërkesës si objekt për përmbareim. Në pikën II, ka Refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit E.H. Kafe Internacional, sa i përket shumës prej 292.17 euro për periudhën 21.12.2017 deri me 28.02.2021 dhe për këtë shumë urdhëri përmbareimor P.nr.97/20 të datës 02.03.2021, mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që ankesa e kreditorit të aprovet si e bazuar, ndërsa aktvendimin e ankimuar PPP.nr.68/2022 të datës 20.12.2022 ta Anuloje për pikën I ose ta ndryshoje aktvendimin e shkallës së parë dhe ta

Refuzojë prapësimin e debitorit E.H. Kafe Internacional, me arsyetimin se borxhi është parashkruar.

Përgjigje në ankese ka parashtruar debitori, me propozimin që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e kreditorit, dhe të mbetet në fuqi aktvendimi PPP.nr.68/2022 të datës 20.12.2022.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigje në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, me datën 02.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit E.H. Kafe Internacional, me seli në Podujevë, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar të librave afarist Nr. 195746, për shumën e borxhit prej 685.31€, nën kërcënimin të përmbartimit me dhunë, përfshirë shpenzimet të procedurës së përmbartimit.

Përmbartuesja private Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm– ekstraktit të verifikuar të librave afarist- nr.195746, e cila paraqet dokument të besueshme në bazë të nenit 29 të LPP-së.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin e përmbartuesit privat, me arsyetimin se ky borxh është parashkruar, dhe se nuk ekziston asnjë bazë me e kërkuar një shumë të tillë, për atë së lokali i cili për disa vite nuk ekziston me, po ashtu ka theksuar se nuk me ka dërguar asnjë fature për borxhin. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë prapësimin e debitorit dhe ta hudhe dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbartimore P.nr.97/21 të datës 02.03.2021.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka theksuar se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me afatin e përgjithshëm të parashkrimit sipas nenit 360 lidhur me nenin 368 të LMD-së, sepse janë faturat mujore ato të cilat debitori e njofton për obligimin e tij ndaj kreditorit dhe debitori është faturuar vetëm me taksë e jo me ujin e shpenzuar, i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Lidhur me prapësimin dhe vërejtjet e aktvendimit të Gjykatës së Apelit 8973/21 dt.09.09.2022, në rivendosje, Gjykata Themelore në Prishtinës-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.68/22 të datës 20.12.2022, ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të këtij aktvendimi, gjykata vlerëson se ka llogaritur shpenzimet e ujit për biznes dhe jo për amvisëri dhe pas konstatimit se në këtë pjesë borxhi i kërkuar është parashkruar pjesërisht për faktin se kreditori pozimin për përmbartim e ka paraqit me datën 02.03.2021 ndërsa

sipas nenit 378, 374 355 lidhur me nenin 360.1 e LMD-së, kreditori e ka humbur të drejtën për realizmin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë para dt.31.12.2013, pra kemi parashkrim të borxhit në shumën prej 393.14€ kurse pjesa tjetër në shumën prej 292.17€ mbetet për tu paguar nga debitori.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore apo kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se pretendimet në prapësim janë pjesërisht të bazuara me ligj, sepse kemi të bëjmë me parashkrim për pjesën e borxhit të cekur si në dispozitiv I dhe pjesa tjetër e borxhit e mbetur në fuqi e cekur si në pikën II.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës u provua se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të borxhit, sipas nenit 355 lidhur me nenin 360 par.1 të LMD-së, , ku përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, në paragrafin 2 përcaktohet : *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*. Vlen të ceket sipas nenin 355 par.1 të LMD-ës përcaktohet se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*. Prandaj, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur prapësimin e debitorit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, sepse kemi parashkrim të borxhit për periudhën 31.12.2013 deri 31.12.2017 shumën prej 393.14 euro, kurse pjesa tjetër e borxhit në shumë prej 292.17 euro për periudhën 31.12.2017 deri 28.02.2021 mbetet për tu paguar nga debitori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzoi si të pabazuara dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës, për arsye se në ankesë nuk provohet se debitori ka realizuar pagesa të pjesërishtme në periudhën kohore të parashkrimit, i cili fakt do të vërtetonte pretendimet ankimore se është ndërprerë parashkrimi nga këto pagesa të debitorit.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave ligjore me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Dhomat e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.sh.II.nr.794/23 me datë 28.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha